

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AGJENICISË KOSOVARE TË PRONËS-AKP-së
ŽALBENO VEÇE KOSOVSKE AGENCIJA ZA IMOVINU-KAI**

GSK-KPA-A-161/15

**Prishtinë,
8 nëntor 2017**

Në çështjen juridike të:

N. D.

Pala ankuese

kundër.

I. A.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Gjyqtarët, Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA14238), të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 8 nëntor 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. D., e paraqitur kundër vendimit KPCC/D/A/244/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA14238), të datës 18 qershor 2014.
2. Anulohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 i datës 18 qershor 2014, sa i përket KPA14238.
3. Hedhet Kërkesa Nr. KPA14238 e N. D. e paraqitur në AKP për shkak të mungesës së juridiksionit.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 27 Shtator 2006, N. D. (tani e tutje: “paraqitësi i ankesës”) ka paraqitur një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 383, arë e kultivuar me sipërfaqe prej 0.27.99 ha, në vendin e quajtur “Jezava”, komuna kadastrale Viti/Vitina Komuna e Vitisë (tani e tutje “prona e kërkuar”). Ai pretendon se pronën e ka fituar me trashigimi nga i ati S. A. dhe se të njejtën e ka humbur në korrik të vitit 1999.
2. Së bashku me kërkesën, paraqitësi i kërkesës i ka dorëzuar AKP-së dokumentet si në vijim:
 - Përshkrimin e fletës poseduese nr. 1708 të lëshuar nga Autoriteti i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë, Komuna e Gjilanit –Dega në Viti, me 21 Shkurt 2000, në të cilën pronat e kërkuara figurojnë në emër të paraqitësit të kërkesës.
 - Kopje e librezës tatimore dhe deshmi mbi pagesën e tatimit në pronë .
 - Letërnjoftim lëshuar nga autoritetet paralele të Komunës së Vitisë me 11 Gusht 1999.
3. Njoftimi i pronave të kërkuara është bërë më 24 Shtator 2010 dhe 26 Shtator 2013. Është gjetur se në ngastrën kadastrale nr. 383 është e zënë nga I. A. i cili pretendon të drejtën pronësore mbi kete pronë mbi bazën e blerjes. Ai plotësoi formën e njoftimit për pjesmarrje në procedurë me 7 tetor 2013 dhe në mbështetje të deklaramit të tij paraqiti:
 - Procesverbalin e rregullimit kadastral të autoritetit të Komasionit për gjendjen faktike me datën 4 Nëntor 1985 me të cilin komisioni 4 anëtarësh i Komasionit konfirmon gjendjen pershkruese faktike se ngastra 383 është blerë nga A. Aj. i ati i palës përgjegjëse dhe kete e konfirmon me nënshkrim edhe N. S. D;
 - Certifikatë lindje e datës 9 Tetor 2013 që dëshmon se pala përgjegjëse është i biri i A. A.
 - Certifikatë vdekje e datës 9 Tetor 2013 që dëshmon se A. A. ka ndrruar jetë me 4 Gusht 2010.
4. Raporti i verifikimit i datës 22 Maj 2014 tregon se lista poseduese është gjetur në emër të 4 bashkëpronarëve, njëri nga ta pala ankuuese si bashkëpronar i 2/6 të pronës së kërkuar.

5. Me vendimin KPCC/D/A/244/2014 të datës 18 Qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK) ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e tij, në paragrafet 80 dhe 81 KKPK-ja ka theksuar se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin mbi pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999, por si rezultat i shitjes në vitin 1985.

Pretendimet e palëve:

Pala ankuese:

6. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabime fundamentale dhe shkelje të rënda të ligjit material dhe se vendimi mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
7. Pala ankuese pohon se pronat e kërkuara i kanë takuar atij edhe pse ai nuk ka pasur posedim as para konfliktit dhe as pas konfliktit dhe si e tillë nuk është dashur të refuzohet mbi bazën e moshumbjes se posedimit si pasoje e konfliktit të armatosur. Të dhenat kadastrale në të cilat thirret pala pergjegjese janë marre nga kadastru pershkrues i vitit 1983 kurse ndrrimet që janë berë janë marur ne Krushevc në kadstrin e zhvendosur pas konfliktit.
8. Në fund, pala ankuese kërkon nga Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës që ndryshoi vendimin e KKPK-së dhe të i njëj pronësinë e palës ankuese dhe ta kthej në posedim.

Pala përgjegjëse në ankesë

9. Pala përgjegjëse deklaroi se pronën e kërkuar e ka blerë i ati i tij tani i ndjerë në vitin 1978 dhe se për këtë ka deshmi të komisionit të Komasionit ku komisioni shumëanëtarësh konfirmon se prona e kërkuar është blerë nga pala ankuese dhe kjo vëretohet me nënshkrimin personal.

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa është e pranueshmesepse është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh siç është paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.
11. Ankesat u shqyrtuan sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se **ankesa është e pa bazuar.**

Arsyetimi ligjor:

Juridiksioni:

12. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetenca për t'i zgjidhur kërkesat që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm të vërtetojë të drejtën e tij pronësore mbi pronën e paluajtshme private por gjithashtu duhet të dëshmojë se ai apo ajo nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur.
13. KKPK-ja ka vendosur se kjo çështje nuk bie në kompetencat e tij pasi që humbja e posedimit nuk ndërlidhet me rrethanat e konfliktit të armatosur por si pasojë e shitjes së vullnetshme para konfliktit.
14. Gjykata Supreme gjithashtu konstaton se e drejta pronësore dhe posedimi mbi pronat e kërkuara nuk është humbur për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998-1999. Ky konstatim bazohet në konfirmimin e zyrtarëve të kadastrit të Komisionit të Komacionit, konfirmon se pala përgjegjëse e ka blere pronën nga pala ankuese.
15. Gjykata Supreme konsideron se faktet e lartpërmendura shpjen në përfundim se humbja e posedimit mbi pronat e kërkuara nuk rrjedh nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur gjatë viteve 1998-1999. Pretendimi i palës ankuese lidhur me vlefshmërinë e tjetërsimit të pronave të kërkuara nuk mund të vlerësohet në këtë procedurë nga Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme për shkak të mungesës së kompetencave.
16. Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së është marrë në vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.
17. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja është dashur të hedhë kërkesën në vend se t'a refuzojë për shkak se bie jashtë juridiksionit. Rrjedhimisht, ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.
18. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për palët e as që paraqet pengesë për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente.
19. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjqtar i EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri, Gjqtar

Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it